

# Informacion Për Punëtorët Migrantë Për Të Qëndruar Të Shëndetshëm Dhe Të Sigurtë Në Punë

Tetor 2020

---

Autoriteti Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë



Çdo ditë, shumë punëtorë aksidentohen në vende të ndryshme pune. Por a e dini se ju dhe punëdhënsi juaj sëbashku keni një rol shumë të rëndësishëm për ta bërë vendin tuaj të punës më të sigurtë? Mund të ndodhë që kur ju vini këtu në Maltë, ju jeni duke bërë një punë që nuk jeni mësuar apo që nuk e keni bërë më parë, ose ndoshta jeni duke përdorur vegla dhe mjete të cilat nuk i keni përdorur kurrë më parë. Puna që bëni tani mund të jetë krejtësisht e ndryshme nga linja e punës që keni pasur në vendin tuaj.

Në Maltë Ligji kryesor që mbron punëtorët në vendet e punës quhet Ligji i Autoritetit për Siguri dhe Shëndet në Punë (Occupational Health and Safety Authority Act, OHS). Ky Ligj dhe rregulloret e tjera synojnë ta bëjnë vendin e punës më të sigurtë dhe t'u japin punëtorëve të drejtat (dhe detyrat) themelore për të garantuar sigurinë e tyre në punë.

---

## Kush mbrohet nga Ligji I Autoritetit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë?

TË GJITHË punëtorët në TË GJITHË vendet e punës si në Maltë ashtu edhe në Gozo.

Kjo do të thotë që përveç punëtorëve që punojnë me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme, të gjithë personat e tjerë që bëjnë një punë (qoftë edhe për disa orë) janë të mbrojtur nga ky Ligj.



## Si mund të aksidentoheni ose sëmureni në punë?

Ka shumë mënyra se si mund të aksidentoheni ose të sëmureni në punë. Është shumë e rëndësishme të mbani mend se nëse ekziston një rrezik, ekziston mundësia e një dëmtimi ose sëmundjeje.

Disa shembuj përfshijnë punën në lartësi pa mbrojtje, bërjen e një pune për të cilën ju nuk jeni të trajnuar, punën me makineri ose mjete të reja, rrëshqitjen në një dyshe të lagura ose të rrëshqitshme, ngritjen e peshave të rënda dhe punën me kimikate pa mbrojtjen e nevojshme. Sigurisht, ka edhe shumë shembuj të tjerë që nuk janë përmendur me lart.

## Çfarë duhet të bëjë punëdhënësi im?

Me Ligj, të gjithë punëdhënësit duhet të mbrojnë shëndetin dhe të sigurojnë sigurinë e të gjithë punëtorëve të tyre në çdo kohë. Për më tepër, punëdhënësi juaj duhet:

- T'ju japë të gjithë **informacionin, mbikëqyrjen dhe trajnimin** e duhur për te mbrojtur shëndetin dhe sigurinë tuaj në punë.
- T'ju informojë për çdo **rrezik** në vendin e punës dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'ju mbrojtur.
- Të sigurojë që ekzistojnë **procedura të sigurta të punës** dhe ndiqen nga të gjithë.
- T'ju japë të gjitha **pajisjet personale mbrojtëse** (si përshebull rripat e sigurimit, helmet sigurie, doreza mbrojtëse ,kufje për veshët) **falas** kur është e nevojshme.
- Te sigurohet që **makineritë, veglat e punës dhe pajisjet mbrojtëse personale** përdoren në mënyre korrekte.





- Te sigurohet që të gjitha **pajisjet e sigurisë** janë në gjendje të mirë dhe mirëmbahen rregullisht. Kjo vlen si për pajisjet mbrojtëse personale, ashtu edhe për mbrojtëset e veglave te punes apo makinerive.

- Te bashkëpunoje me **përfaqësuesit e punëtorëve** të cilët janë zgjidhur nga vetë punëtorët.

- Te sigurojë hapësira të përshtatshme për **mirëqenien** e punëtorëve në punë (si kushte të përshtatme higjieno-sanitare etj.).
- Të marrë masat e duhura për të reduktuar ose shmangur **ngritjen e ngarkesave me pesha të rënda** te cilat mund të shkaktojnë dëmtime.
- Të sigurojë që çdo punëtorë ka akses për **ndihmën e parë** në vendin e tij të punës.
- T’ju informojë për çdo **urdhër inspektimi apo raport** në lidhje me shëndetin dhe sigurinë të lëshuar nga Autoriteti i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OHSA).
- **Nuk mund t’ju pushojë nga puna** kur ju refuzoni të bëni një punë që është e rrezikshme për shëndetin tuaj.

## Çfarë përgjegjësish kam unë si punëtor?

Si punëtor, ju gjithashtu keni përgjegjësitë e tuaja në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë. Në fakt, ju duhet te:

- **Kujdeseni** për sigurinë dhe shëndetin tuaj dhe të punëtorëve të tjerë që punojnë me ju të cilët mund të preken nga puna që ju kryeni.
- **Përdorni me korrektësi** të gjitha mjetet dhe pajisjet mbrojtëse personale që punëdhënësi juaj ju kërkon të përdorni.
- **Bashkëpunoni** me punëdhënësin tuaj, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëtorëve.
- **Njoftoni punëdhënësin, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëtorëve** për çdo situatë pune ku veglat, mjetet, pajisjet e punës janë të dëmtuara dhe paraqesin një rrezik të rëndë për sigurinë dhe shëndetin tuaj.

- **Mos përdorni** asnjë pajisje pune ose makineri që mund t'ju dëmtojë juve ose punëtorët e tjerë në punë.
- **Veproni** me përgjegjësi në vendin tuaj të punës.
- **Raportoni çdo lloj rrezikun serioz apo** shkelje të Ligjit tek Autoritetet kompetente (OHSA) apo tek punëdhënësi ose mbikëqyrësi juaj.

## Çilat janë të drejtat e mia ligjore?

Sipas Ligjit të Autoritetit Për Sigurinë dhe Shëndetin Në Punë (OHSA), ju keni të drejtën të:

- Informohenin për çdo rrezik për shëndetin dhe sigurinë në vendin tuaj të punës.
- Të merrni pjesë në mirëmbajtjen e një vendi pune më të mirë dhe më të sigurtë.
- Refuzoni të bëni një punë që vendos në rrezik shëndetin dhe sigurinë tuaj.
- Punoni në një vend pune të sigurtë dhe të shëndetshëm, pa frikë nga dhuna ose ngacmimi.

## Ku mund të marr më shumë informacion?

Ju mund të kontaktoni Autoritetin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OHSA) për të gjitha shqetësimet dhe pyetjet tuaja në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në vendin tuaj të punës. Jini të sigurt për konfidencialitetin të plotë - ne nuk u zbulojmë asnjë informacion punëdhënësve se kush ka bërë një ankesë ose ka kërkuar ndihmën tonë për një hetim më të detajuar në vendin e tij të punës. Për më tepër, ju gjithashtu mund të na kontaktoni në mënyrë anonime.

## Si mund të kontaktoj OHSA?

OHSA mund të kontaktohet në mënyra të ndryshme:

Adresa: 17, Rruga Edgar Ferro, Pietá PTA 1533, Malta

Numri i Telefonit: 21247677

Numri i Emergjencës: 99496786

Adresa Elektronike: [ohsa@gov.mt](mailto:ohsa@gov.mt)

Facebook: OHSA Malta

Shkarko Falas Aplikacionin në Celularin Tuaj: BSafe@Work

